



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 17.12.2018

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS TË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE (INSTAT)

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 17 dhjetor 2018, shqyrtoi propozimin e INSTAT për miratimin e strukturës së re, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të këtij institucioni, propozim ky i ardhur në zbatim të ligjit nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, neni 15, pika 3 si dhe neni 40, pika 5 dhe i cili është depozituar me shkresën nr.prot 3547, datë 09.11.2018. Ndërsa me shkresën prot. 3547/2, datë 14.12.2018, është kërkuar nga INSTAT-i rishikimi i propozimit fillestar duke reflektuar shtesën prej 10 punonjësish të miratuar në ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”.

Në mbledhjen e Komisionit ishte e pranishme për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve Znj. Delina Ibrahimaj, Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT-it si dhe përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Struktura organizative e INSTAT-it reflekton rekomandimet e ekspertëve të Eurostat-it, të pasqyruara në raportin “Limited Peer Review”, për vlerësimin e Sistemit Kombëtar Statistikor në Shqipëri, si dhe rekomandimet e Komisionit Evropian në Raportin e Progresit, duke propozuar krijimin e tre drejtorive të përgjithshme sipas tre fushave kryesore të përgjegjësi: prodhim, infrastrukturë dhe komunikim. Këto drejtori do të asistojnë Drejtorin e Përgjithshëm në menaxhimin e institucionit e konkretisht në menaxhimin e prodhimit statistikor, menaxhimin e infrastrukturës dhe menaxhimin e shërbimeve mbështetëse me efektivitet dhe efikasitet. Krijimi i këtyre drejtorive të përgjithshme dhe riorganizimi që i është bërë drejtorive dhe sektorëve të tjerë, do të rrisë performancën e institucionit në drejtim, menaxhim, monitorim dhe ndjekje të çdo aspekti në realizimin e statistikave zyrtare.

Gjithashtu, në zbatim të Ligjit nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, nenit 16, pikës 2, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.893, dt 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës

shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, duke qenë se Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it do të zgjidhet nga Kuvendi dhe nuk do t' i nënshtrohet më ligjit “Për Nëpunësin Civil”, lind nevoja e krijimit të pozicionit të Sekretarit të Përgjithshëm si nëpunësi më i lartë civil i këtij Institucioni.

Në zbatim të nenit 9, pika 2 të ligjit nr.9584 datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” është marrë mendimi për këtë strukturë si nga Ministria e Financave ashtu dhe nga Departamenti i Administratës Publike. Si Departamenti i Administratës Publike, ashtu edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë shprehur parimisht dakord me projektstrukturën organizative të propozuar nga INSTAT.

Duke qenë se ky riorganizim bëhet sipas rekomandimeve periodike të Komisionit Evropian dhe Eurostat-it, për të garantuar jo vetëm zbatimin e aktiviteteve por edhe cilësinë e produkteve statistikore të prodhuara, në përmbushje të objektivave dhe zbatimit të detyrimeve që rrjedhin në kuadër të procesit të integritetit evropian, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave e miratoi propozimin me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

KRYETARI

Erjon BRAÇE